

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit E.D., për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, av. O.H., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog P.nr.24/2016 të datës 22.12.2016 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.130/2017 të datës 08.11.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 01 tetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit E.D., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog P.nr.24/2016 të datës 22.12.2016 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.130/2017 të datës 08.11.2017 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, me aktgjykimin P.nr.24/2016 të datës 22.12.2016, të dënuarin E.D., e ka shpallur fajtor për veprën penale kanosja nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda afatit prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguaj shumën

prej 40€, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.130/2017 të datës 08.11.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësit e të dënuarit, avokati O.H. nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën ti anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.146/2018 të datës 29.08.2018, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënëpar.1.8 të KPPK-së, meqë në aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë bazuar në prova të papranueshme dhe atë në raport me veprën penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj. Pretendohet se në këtë çështje penale gjykata me asnjë provë nuk ka vërtetuar kryerjen e veprës penale nga i dënuari pasi që për të vërtetuar veprimet e tij ka qenë dashur që të ketë identifikim të saktë përmes ekspertizave përkatëse teknologjike se i dënuari ka përdorur profil të rrejshëm në facebook në emër L.M., me qëllim që të kryej kanosjen ndaj të dëmtuarit.

Po ashtu pretendohet se me këtë rast ka qenë dashur që të bëhet angazhimi i ekspertit nga fusha e telekomunikacionit dhe në bazë të saj do të vërtetohej saktësisht personi që ka bërë kanosjen përmes rrjetit social a ka qenë i dënuari apo ndonjë person tjetër, ashtu që me mos bërjen e ekspertizës përkatëse nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është vërtetuar në mënyrë të saktë se i dënuari ka kryer këtë vepër penale.

Mbrojtja në kërkesë gjithashtu pretendon se me asnjë provë bindëse nuk është vërtetuar fajësia e të dënuarit dhe se nuk është vërtetuar në mënyrë të saktë fakti se kush qëndron prapa kanosjes pasi që kryerësi i veprës penale ka shkruar me emër tjetër përmes rrjetit social facebook përkatësisht me emrin L.M., ashtu që ka mundur të jetë ndonjë person tjetër dhe jo i dënuari.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur fakte të plota dhe të qarta dhe në mënyrë të detajuar nuk janë arsyetuar të gjeturat e gjykatës. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë faktet vendimtare përkatësisht vërtetimin e ekzistimit të veprës penale dhe faktin se i dënuari ka qenë personi që ka shfrytëzuar llogarinë në rrjetin social facebook në profilin e L.M. dhe përmes kësaj ka bërë kanosjen ndaj të dëmtuarit B.B.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 par.7 të KPPK-së dhe nuk janë dhënë arsyetime se cilat fakte i konsideron të vërtetuara përkitazi me veprimet e të dënuarit pasi që nuk është vërtetuar me saktësi fakti kryesor se kanosjen e ka bërë i dënuari, meqë vepra penale ka qenë e kryer përmes rrjetit social dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur arsyetim përkitazi me

provat kontradiktore dhe nuk ka dhënë arsye të qarta se në bazë të cilave prova e bazon vendimin e saj përveç që në mënyrë narrative ka përshkruar provat përkatësisht dëshmitë e dëshmitarëve e të cilët nuk kanë vërtetuar faktin vendimtar se pikërisht i dënuari kishte bërë kanosjen e për më tepër nuk ka paraqitur arsye se pse nuk i ka besuar mbrojtjes së të dënuarit mirëpo këtë e ka përshkruar se “ ...gjykata nuk ia fali besimin pasi që një mbrojtje e tillë është e pa bazë dhe e pa argumentuar...”, i cili arsyetim është vetëm përshkruar dhe pa ndonjë vlerësim kritik dhe të qëndrueshëm përkitazi me mbrojtjen e të dënuarit në raport me provat e tjera të administruara.

Po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës nuk ka evituar shkeljet e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht nuk ka vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së dhe mbi këtë bazë të dy aktgjykimet janë të paligjshme dhe të cilat konstatime nuk mund të pranohen nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të eliminoj shkeljet e konstatuara, të shqyrtoj provat e propozuara si dhe prova tjera të nevojshme e të cilat duhet ti vlerësoj në kuptim të nenit 361 par.1 të KPPK-së dhe të jep arsyetim të qartë dhe të plotë për faktin se përmes profilit të L.M. mesazhe të kanosjes ka postuar i dënuari dhe nëse është e nevojshme për këtë të bëj edhe ekspertizë përkatëse dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishe e bazuar dhe konform nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.211/2018, më datë 01 tetor 2018

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta